

RÖFIX EPS-P 035

EPS- Pllaka izolimi për zonën e xokolaturës

Udhëzime teknike dhe ligjore:

Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skemat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit, si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve.

Fushat e përdorimit:

Pllakë shkume të ngurtësuar prej polisteroli EPS-P30 (WLG 035) shumë e zgjeruar për formimin e izolimin rrethues dhe të xokolaturës.

Me sipërfaqe te valëzuar

I përshtatshëm për ndërtesa të vjetra dhe të reja.

Si pllakë termoizolimi për sektore, në të cilat thithja e ujit dhe forca ngjitëse ndërmjet sipërfaqes së pllakës izoluese dhe suvasë, kërkon standarte të larta cilësie.

Karakteristikat:

- Vetë izoluese optimale
- Saktësi në matje, falë pjesëve speciale prej shkume
- Qëndrueshmëri e lartë e formës edhe në raste temperaturash të larta dhe ngarkese.
- Pa HFCKW- dhe HFKW

Përpunimi:

Të dhëna teknike			
SAP-Art. Nr.:	2000148766	2000148769	2000148134
NAV-Art. Nr.:	111321	111324	111325
Lloji i paketimit			
Njesi per palete	10 Copë/Nj.	6 Copë/Nj.	5 Copë/Nj.
Sasi për njësi	5 m ² /Nj.	3 m ² /Nj.	2,5 m ² /Nj.
Trashësia	50 mm	80 mm	100 mm
Gjerësia	1.000 mm		
Lartësia	500 mm		
Përçueshmëria ndaj avujve të ujit μ	ca. 60		
Përcjellshmëria termike	0,031 W/mK		
Qëndrueshmëria ndaj tërheqjes tërthore	≥ 150 kPa		
Kapilariteti	< 0,03 kg/m ² h		
Dendësia bruto	ca. 30 kg/m ³		
Klasi- R	1,45 m ² K/W	2,3 m ² K/W	2,9 m ² K/W
Temperatura e bazamentit	> 5 °C		
Reaksioni ndaj zjarrit	E (EN13501-1)		

Baza e materialit:


- Material izolues styropor prej materiali shkume të fortë të hidrofobuar, i prodhuar nga trajtimi me nxehtësi i thërimeve të polisterolit.

Kushtet e punimit:

Gjatë fazës së tharjes dhe përpunimit, temperatura e ambientit dhe bazamentit nuk duhet të bjerë nën +5 °C.

Përpunimi:

Ngjitja e pllakave izoluese: Në zonën e xokolaturës përhapeni ngjitësin me një mallë me dhëmbë 10 x 10 ose me metodën me pika/metoda me vija (afërsisht 40 % sipërfaqe e ngjitur) mbi sipërfaqen e pasme të pllakës. Pllakat e xokolaturës duhet min. 30 cm në zonën ku uji sprucon të arrijë deri në kufirin e taraces. Pllakat izoluese duhet që gjatë ngjitjes të vendosen në nivel dhe të puthitura mirë me njëra-tjetrën. Pllakat izoluese të xokolaturës duhet të kapen me tiplla në kufirin e sipërm, sipas rregullave themelore të aplikimit të sistemit të termoizolimit.



RÖFIX EPS-P 035

EPS- Pllaka izolimi për zonën e xokolaturës

Këshilla në rast reziku: Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.

Magazini: Magazinojeni në vende të thata, nga lagështia dhe ndikimet UV (dielli, drita).
Koha e magazinimit min. 12 muaj.

Deklaratë:



Këshilla të përgjithshme: Kjo skedë teknike anullon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme. Të dhënat e këtyre udhëzuesve teknike përkojnë me njohuritë dhe përvojën tonë praktike të deritanishme.

Ky informacion dhe të dhënat janë përpiluar me kujdes dhe me ndërgjegje të plotë, por pa mbajtur përgjegjësi për vendime ose veprime plotësuese që mund të marrë vetë konsumatori. Të dhënat në vetevete nuk provojnë asnjë lidhje ligjore ose detyrime të tjera anësore, dhe normalisht nuk e ndalojnë konsumatorin të testojë produktin për ato qëllime për të cilat edhe është prodhuar. Produktet RÖFIX si dhe të gjitha materialet përbërëse, i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, me anë të të cilit garantohet një cilësi e pandryshueshme.

Stafi ynë është i gatshëm tju japë cdo ndihmë teknike në lidhje me përdorimin, përpunimin si dhe mund të ofrojë edhe trajnime praktike në lidhje me përdorimin e produkteve tona.

Skedat tona teknike më të reja, me të dhënat aktuale, mund ti gjeni edhe në faqen tonë të internetit (www.roefix.com), ose mund të kërkohen edhe pranë filjaleve rajonale në vënd.